



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-25508/18 datë: 22.08.2018



Npi – 01/225 Datë: 31.08.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-22895/18 datë: 01.08.2018, të z. Shaban Halimi, nga fshati Godanc i Poshtëm, Rr. "Kozhinca" Nr.210, i cili ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, në emër të 50 banorëve të lagjes "Kozhinca" të vërtetuara me nënshkrimet e tyre, që të zbatohet vendimi i Kuvendit Komunal-Shtime Nr.01/060/01-27185/17 i datës 08.09.2017 me të cilin aprovohet kërkesa Nr.01-70/05-25064/17 datë 15.09.2017, e znj. Miradie Halimit (delegatë e Kuvendit) nga Godanci i Poshtëm, që të futet në listën e projekteve kapitale në Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2018, asfaltimi i rrugës "Kozhinca" në fshatin Godanc i Poshtëm. Kuvendi i Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, Nr.01-070/05-22895/18
TË SHABAN HALIMIT NGA FSHATI GODANC I POSHTËM**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 31.08.2018, me shumicën e votave vendosi që kërkesa, Nr.01-070/05-22895/18, datë: 01.08.2018 e Shaban Halimit nga fshati Godanc i Poshtëm të refuzohet, mirëpo për shkak të pamundësisë të zbatimit të vendimit në vitin 2018, Kuvendi i Komunës vendosi që asfaltimi i rrugës "Kozhinca" të futet në listën e projekteve kapitale me prioritet për vitin 2019.

II

Për kërkesën e palës, Kuvendi ka vendosur duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj



Npi – 01/224 Datë: 31.08.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-70/05-19909/18 datë: 09.07.2018, të z.Ekrem Ademaj, nga fshati Petrovë, Rr.“Hyrë Emini” Nr.54, i cili në emër të familjarëve të vetë, Ekrem, Zenun, Lulzim, Rexhep dhe Samir Ademaj, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, që të emërtohet rruga që shkon në lagjen e tyre e që lidhet me rrugën kryesore, “Hyrë Emini” në drejtimin Shtime-Mollopolc, me emrin e familjarit të tyre: “JAKUP ADEMAJ”. Kuvendi Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, Nr.01-70/05-19909/18 TË EKREM ADEMAJ NGA FSHATI PETROVË

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën 31.08.2018, me shumicën e votave vendosi që kërkesa, Nr.01-70/05-19909/18 datë:09.07.2018, e z.Ekrem Ademaj, nga fshati Petrovë, të Refuzohet, sipas Rekomanimit të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.

II

A r s y e t i m: Kërkesa është refuzuar me arsyetimin se nuk është në pajtim me Ligjin Nr.04/L-071 “PËR SISTEMIN E ADRESAVE”, neni 8, paragrafi 2 i cili thotë “Në rrugën me një dalje vendoset emër i veçantë nga emri i rrugës kryesore nëse: Kur në të ka mbi dhjetë (10) banesa-shtëpi ose kur në planin rregullues parashikohet dalje në një rrugë tjetër. I njëjti kriter zbatohet edhe në fshatra”, dhe paragrafi 3 i cili thotë “Për rrugicat me një dalje ose me më pak se dhjetë (10) banesa-shtëpi, përdoret emri i njëjtë i rrugës ku ato kanë dalje.”

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj



Npi – 01/223 Datë: 31.08.2018

Bazuar në nenin 40.2.d, si dhe neni 58 pika (j), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 45.4 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, si dhe mbi bazën e prezentimit të Raportit finaciar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018, nga Zyra Komunale për Financa, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.08.2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RAPORTIT FINANCIAR TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR GJASHTË MUJORIN E PARË – 2018

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 31.08.2018, me shumicën e votave aprovoi, Raportin Finaciar të Komunës së Shtimes për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018.

II

Raporti finaciar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



Npi – 01/222 Datë: 31.08.2018

Duke u bazuar në nenet 40.2.b dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenet 60 dhe 61 të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-48; Si dhe nenin 8.1 të Rregullores për Transparencë 01Nr.06/361/4, të datës 04.03.2009, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 31.08.2018 mori këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK PLANIN BUXHETOR TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2019

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e tetë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më:31.08.2018, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2019, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë dhe Financa.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës Komunale për Financa, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj